



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1016/4 Prot.

Patos, më 22/04/2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 22 PRILL 2026

Vendi: Njësia administrative Zharrëz, Salla e mbledhjeve

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjuesë publike me temë: “Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027-2029”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”.

Pjesëmarrës: Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Zv/ Kryetare znj. Ina Sauli, Drejtore e Financave znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve, z. Sokol Meta, Anëtarë GMS, përfaqësues të bashkisë Patos, me pjesëmarrjen e *31 pjesëmarrësve (banorë, përfaqësues të shoqatave dhe shoqërisë civile, kryetarë të fshatrave etj)*

Takimin hapet nga sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba

Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba- Të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Sekretare e Këshillit
Znj. Refaela Xeba**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

pjesë të kësaj dëgjese publike. Tema e kësaj dëgjese është “Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027-2029”. Kjo dëgjese është e bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”. Jemi në hapat e parë të procedurës për hartimin e PBA-së dhe presim kërkesat tuaja. Do ju lutesha që fjala të merrej me rradhë dhe të prezantoheshit gjatë kërkesave tuaja. Ju faleminderit!

Banor i Zharrëz, z. Tajar Hajdini– Përshëndetje të gjithëve! Te kopshti bari ka ngelur pa pastruar, fëmijët janë në rrezik pasi mund të sulmohen nga gjallesat, varrezat e Zharrësës janë



**Banor i Zharrëz
z. Tajar Hajdini**
Dëgjese publike me temë:
**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**
Prill 2026

pa pastruar. Duhet të dërgoni për të pastruar varrezat. Këtu nuk kalon dot në asnjë rrugë. Kanalet duhen pastruar.

Banor i Zharrësës, z. Kristaq Tereziu- Përshëndetje! Unë kam një kërkesë për zonën e Zabijes pasi nuk është bërë akoma. Lagjja e Çobanëve ka mbetur pa kosh mbeturinash. Ura po gërryhet dhe po shkatërrohet, duhet ndërhyrë.



**Banor i Zharrësës
z. Kristaq Tereziu**
Dëgjese publike me temë:
**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**
Prill 2026

Banor i Zharrësës, z. Fuat Bani – Përshëndetje! Zharrëza është lënë pas dore krahasuar me disa fshatra. Ne nuk kemi anëtarë Këshilli që të na delegoj kërkesat që ne kemi. Në fshatin tim nuk ka ndriçim. Kosh mbeturinash nuk kemi. Unë nuk marr asgjë nga bashkia, as ujë, as drita, as KUZ, as pastrim kanalesh, as pastrim ferrash. Rruga “Halit Gjeriti” nuk ka ndriçim. Rruga është e ngushtë dhe mbuluar nga ferrat nuk shkëmbehen dot makinat.



**Banor i Zharrësës
z. Fuat Bani**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Administrator i njësisë administrative Zharrëz, z. Riza Hoxha- Për pjesën e koshave dua të them që pastrimi bëhet i përditshëm nga makina dhe kishat do të vendosen sapo të kaloj projekti që është folur me pajisjen e koshave që do përfshijë gjithë fshatin.



**Administrator i njësisë administrative
Zharrëz
z. Riza Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve, z. Sokol Meta- Rruga te ju do të bëhet gjatë këtij vitit



**Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve z.
Sokol Meta**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

ashtu siç është thënë dhe është parashikuar. Ne sot kemi ardhur për të marr kërkesat për vitin tjetër. Të gjitha problemet që po ngrini do ti shikojmë bashkë sot në terren dhe do ti zgjidhim. **Banor i fshatit Sheqishte, z. Viktor Prifti**- unë kam një tokë në Sheqishte dhe aty është hapur një stallë me qenë. Kjo ka shkaktuar probleme në tokën time dhe në prodhimin tim të grurit.



**Banor i fshatit Sheqishte
z. Viktor Prifti**

**Dëgjese publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Drejtoresh e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari- Kur kemi prezantuar buxhetin e 2026 kemi thënë që Zabija dhe koshat janë parashikuar në 2026, por këto nuk bëhen brenda ditës. Ka një procedurë që ndiqet nga bashkia dhe gjërat bëhen me radhë.



**Drejtoresh e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari**

**Dëgjese publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Banues në fshatin Verbas, z. Faik Xhoraj- Unë kam kërkesë për rrugën e Verbasit, rruga Xhoraj, pasi nuk është shtruar.



**Banues në fshatin Verbas
z. Faik Xhoraj**

**Dëgjese publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Banor i Zharrëz, z. Erigels Bahu- Përshëndetje! Unë kam një kërkesë për të moshuarit dhe



**Banor i Zharrëz
z. Erigels Bahu**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

krijimin e një ambjenti shplohës për ta në mënyrë që ta kalojnë kohën e lirë. Gjithashtu kam edhe një kërkesë lidhur me investimin dhe pastrimin e përroit të Zharrëzës. Duhet shtruar dhe rrugën e parcelave që tu lehtësoj fërmerëve kalimin. Gjithashtu duhet bërë edhe diçka për pjesën e punësimin. Bari dhe pemët duhen pastruar dhe korrur. Varrezat e Zharrëzës janë pa pastruar.

Banor i fshatit të Ri, z. Hysen Hoxha- Në lagjen tonë nuk ka rrugë të shtruar dhe nuk kalon



**Banor i fshatit të Ri
z. Hysen Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

dot. Bëhet fjalë për rrugën e fshatit të Ri këtu në Zharrëz te Ngjeliu. Është grryer një rrugë e lagjes nga ujësjellsit u bë gati për tu shtruar dhe nuk u shtrua. Kosha mbeturinash kam kërkuar dhe më para dhe nuk na kanë sjell. Kam një tokë bujqësore dhe më kanë lënë një procesverbal lidhur me një ankesë që kam bërë më parë dhe i kanë lënë fqinjët detyrë të bëjnë kanalën ngjitur dhe të marr masa pasi më ka kthyer ujin nga sera ime. Ai akoma se ka zbatuar atë detyrë dhe nuk e ka hapur kanalën. Kam paguar taksat sot dhe lexoj që kam paguar ujin e vaditjes, por unë nuk kam ujë për vaditjen.

Administrator i njësisë Zharrëz, z. Riza Hoxha- Për sa i përket taksës nuk keni paguar




**Administrator i njësisë Zharrëz
z. Riza Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

taksën e vaditjes, por taksën e tokës bujqësore sipas Paketës Fiskale dhe madje e keni përfituar dhe me zbritje.

Banor i Zharrëzës, z. Vladimir Hoxha- Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak më ka bërë përshtypje që kur folik këshilltari i zonës tonë këtej asnjë nuk e mbështeti. Për Zharrëzën përveç shkollës nuk u listua asnjë investim tjetër.



**Banor i Zharrëzës
z. Vladimir Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Kryetar i fshatit të Ri, z. Bexhet Rredhi- Rruga e Ferrajve duhet futur për investim, duhet bërë. Ndriçim nuk ka në fshatin tonë.



**Kryetar i fshatit të Ri
z. Bexhet Rredhi**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Banor i Zharrëzës, z. Bardhyl Asllani- Kam kërkesë për rrugën "Halit Gjeriti" te sektori 6, duke filluar nga grupi deri te xhadeja kryesore që është bërë plot me gropa, duhet hapur dhe shtruar. Ambulanca e fshatit nuk ka staf mjekësor, të moshuarit nuk kanë ku trajtohen.



**Banor i Zharrëzës
z. Bardhyl Asllani**

**Dëgjesë publike me temë:
"Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029".**

Banor i Zharrëzës, z. Shaqo Çole- Përsëritet! Rruga te Banallarët lart, rruga Çole është në gjendje të keqe dhe nuk kalohet më. Edhe kur u hap nga ujësjellsia rruga ngeli hapur dhe se kanë mbyllur. Rrugë parcele për të ulla të nuk ka dhe duhen shtruar me çakull. Bëhet fjalë për parcelën 105 te Koroveshajt. Duhet dhe ndriçim dhe pastrim kanali te lagjja jonë.



**Banor i Zharrëzës
z. Shaqo Çole**

**Dëgjesë publike me temë:
"Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029".**

Prill 2026

Zv/ Kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- Nëse nuk kemi kërkesa të tjera e deklaroj të mbyllur këtë dëgjesë publike. Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos
znj. Ina Sauli**

**Dëgjesë publike me temë:
"Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029".**

Prill 2026

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba